



KUVENDI

Revistë e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 34, Qershor 2012



Fëmijët e ardhmja e vendit


Përmbajtja

Katër vjetori i Shpalljes së Republikës së Kosovës	3
Shqiptarët të bashkuar në Jubileun e 100- vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë	7
Hungaria mbështet Kosovën në procesin liberalizimit të vizave dhe të integriteteve euro-atlantike	9
Kosova ka mundësi historike për të ecur përpara	10
Kosovë – Maqedoni impulse të reja bashkëpunimi	13
Legjislatura IV	14
Përmirësime në rregulloren e Kuvendit	17
Mblidhet Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit	22
Projektligji avancon sektorin bankar në Kosovë	23
Shuhet Gjeneralmajor, Shaban Shala	25
8 Marsi - Në Kuvendin e Republikës së Kosovës	27
Alternativat e energjisë në Kosovë	29
Pyetjet Parlamentare	31
Takimet e Kryetarit të Kuvendit	34



E boton: Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun
Redaktoi: Petrit Subashi, Zyrtar I Lartë për Publikime

ZVICËR



Kryetari i Këshillit Kombëtar të Zvicrës, Walter,
Shefi i Departamentit të Punëve të Jashtme, Burkhalter,
Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Dahinden
Kryetari i qytetit të Bernës, Tschäppät...

...pritën delegacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës,
të kryesuar nga Kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi

Me ftesë të kryetarit të Këshillit Kombëtar të Zvicrës Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, në krye të një delegacioni parlamentar, ka zhvilluar më 7 mars 2012, një vizitë zyrtare katër ditore në Zvicër. Me të mbërritur në Berne, zhvilloi takimin e parë me drejtorin e Drejtorisë për Zhvillim dhe Bashkëpunim, z. Martin Dahinden dhe me kryetarin e qytetit të Bernës, z. Alexander Tschäppät.

Z. Krasniqi; Mirënjohje miqve zviceranë për mbështetjen, që Zvicra i ka dhënë Kosovës, në periudhat e rënda nëpër të cilat ajo ka kaluar.

E mbështesim Kosovën sepse ndihemi afër saj



Delegacioni parlamentar i Kosovës - kryetari i Këshillit Kombëtar të Zvicrës, Walter

Kryetari Krasniqi i njoftoi mikpritësin me zhvillimet në Kosovë, ndërtimin e institucioneve demokratike dhe me objektivat e tyre, njohjet ndërkombëtare, për punën e Kuvendit etj. Kryeparlamentari u shprehu mirënjohje miqve zviceranë për mbështetjen e shtetit të tyre ndaj Kosovës në periudhat e rënda nëpër të cilat ajo ka kaluar. Ai përmendi edhe marrëveshjet që Kosova dhe Zvicra kanë arritur, duke kërkuar që marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve të thellohen dhe zgjerohen më tej.

Kryetari i Këshillit Kombëtar zviceran shprehu respektin për Kosovën dhe të kaluarën e saj. “Ne e kemi mbështetur Kosovën, sepse jemi ndier afër saj”, tha Walter, ndërsa përmendi prezencën e madhe të qytetarëve të Kosovës në Zvicër dhe mundësinë që edhe ata të investojnë në Kosovë.

Në këtë kontekst, u fol edhe për shkollimin e të rinjve të Kosovës në Zvicër dhe arritjet e tyre atje, në shumë fusha.

Në takimin me Komisionin për Politikë të Jashtme i Këshillit Kombëtar të Zvicrës dhe shefi i Departamentit të Punëve të

Jashtme, z. Didier Burkhalter, u bisedua për aspekte të ndryshme ndërkombëtare të Kosovës.

z. Krasniqi iu përgjigj interesimit të parlamentarëve zviceranë për çështje të ndryshme, si: zhvillimi ekonomik i Kosovës, dialogu e marrëdhëniet me shtetet fqinje, korrupsioni e krimi i organizuar, raporti i Dik Martit etj.

Delegacioni i vijoi në takimin me kryetarin e Këshillit të Shteteve, z. Hans Altherr dhe në përfundim do të japin një konferencë të përbashkët shtypi, kryetari Krasniqi dhe kryetari i Këshillit Kombëtar të Zvicrës.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi, në krye të delegacionit shoqërohet nga Safete Hadërgjonaj, kryetare e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Teuta Sahatçija, zëvendëskryetare e parë e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Mehmet Hajrizi, shef i kabinetit të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Skender Reçica, këshilltar për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Kosova dhe Irlanda, si vëllezër siamez

Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, takim me kryetarin e Kuvendit të Irlandës së Veriut, z. William Hay.

Angazhime për të thelluar më tej bashkëpunimin ndërmjet dy parlamenteve
Nënshkruhet një marrëveshje në fushën e bashkëpunimit të administratave përkatëse



Nga takimi Krasniqi -Hay

Marrëdhëniet ndërmjet kuvendeve dhe institucioneve tjera të Kosovës dhe Irlandës së Veriut janë shumë të mira. Kosova dhe Irlanda kanë shumë të përbashkët në jetën shoqërore e institucionale, si në të kaluarën, ashtu edhe në të tashmen, ndaj kanë çfarë të mësojnë nga njëra - tjetra. Ky ishte një nga vlerësimet më thelbësore nga takimi i sotëm i kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, me kryetarin e Kuvendit të Irlandës së Veriut, z. William Hay.

Z. Krasniqi tha se marrëdhëniet ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar e Kosovës janë shumë të mira, ashtu siç janë edhe ato ndërmjet Kosovës dhe Irlandës së Veriut, përkatësisht kuvendeve përkatëse. Bashkëpunimin e tregojnë qartë vizitat reciproke të delegacioneve parlamentare si dhe ato të komisioneve.

E përbashkëta ndërmjet Irlandës dhe Kosovës, shtoi më tej kreu i legjislativit të vendit Krasniqi, është se dy personalitete të njohura botërore, siç janë z. Klinton dhe z. Bler kanë ndihmuar në procese të rëndësishme të Kosovës dhe të Irlandës së Veriut.

Z. William Hay theksoi se Irlanda e Veriut dhe Kosova kanë kaluar nëpër periudha të konflikteve, madje ato kanë të përbashkët edhe faktin se afërsisht për nga territori dhe popullsia janë të barabarta. Po kështu, kanë edhe përvoja të përafërta në ngritjen e institucioneve, por ato kanë edhe një varg çështjesh të mbetura nga e kaluara, siç janë të zhdukurit, plagët e luftës, pastaj çështjet ekonomike, segregacioni etj.

Z. Hej shprehu angazhimin për të forcuar edhe më bashkëpunimin ndërmjet dy kuvendeve, për të shtyrë gjërat përpara. Në këtë frymë, ai tha se roli bashkësisë ndërkombëtare, si në rastin e Irlandës, ashtu edhe të Kosovës, është i një rëndësie të veçantë. "Pa mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare, as në Irlandë të Veriut dhe as në Kosovë, s' do të mund të arriheshin këto suksese. Mbështetja ndërkombëtare në të gjitha zhvillimet aktuale është e një rëndësie të veçantë.

U nënshkruan marrëveshja ndërmjet Parlamentit të Irlandës së Veriut dhe Kosovës, në fushën e bashkëpunimit të administratave përkatëse.

T U R Q I A

Kosova - faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon



Turqia do të vazhdojë të mbështesë Kosovën
në të gjitha aspektet

Kryetari i Kuvendit të Madh të Turqisë, z. Cemil Çiçek
Presidenti i Republikës së Turqisë, z. Abdullah GÜL
Kryeministri i Turqisë z. Recep Tayyip ERDOĞAN

...presin delegacionin parlamentar të
Kuvendit të Kosovës të kryesuar nga
Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi

Çiçek - Turqia do të vazhdojë të mbështesë Kosovën në të gjitha aspektet

Me ftesë të kryetarit të Kuvendit të Madh të Turqisë, z. Cemil Çiçek, kryetari i Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, në krye të një delegacioni parlamentar kreu një vizitë zyrtare në Republikën e Turqisë. Kryekuvendari Krasniqi, i shoqëruar nga nënkryetari i Kuvendit: Enis Kervan dhe nga deputetët Nait Hasani, Alma Lama dhe Myfera Shinik, si dhe nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Ankara, Bekim Sejdiu, është pritur në takime të ndara nga kryetari i Kuvendit të Madh të Turqisë, z. Cemil ÇİÇEK dhe presidenti i Republikës së Turqisë, z. Abdullah GÜL.



Krasniqi - Çiçek

Kryetari i Kuvendit të Kosovës dr. Jakup Krasniqi, u shprehu mirënjohjet më të thella Turqisë dhe popullit turk për mbështetjen, që i ka dhënë dhe po i jep Kosovës. Duke përmendur marrëveshjet, që Kosova dhe Turqia kanë arritur, ka theksuar se marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve tona janë të shkëlqyera në fushën politike. duhet të thellohen dhe zgjerohen edhe më tej, sidomos në bashkëpunimin më të thellë ekonomik.

Kryetari Krasniqi i njoftoi mikpritësit për zhvillimet në Kosovë, si dhe për hapat e mëdhenj që ka bërë vendi pas shpalljes së pavarësisë, duke u shndërruar kështu në një faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon.

Duke folur për afirmimin ndërkombëtar të Kosovës ai ka përmendur faktin që Kosova deri më tani është njohur nga 90 vende të ndryshme të botës, anëtare të OKB-së.

Sfidat me të cilat po ballafaqohet vendi, z. Krasniqi theksoi se pengesë serioze e bashkëpunimit të gjithanshëm të Kosovës me BE-në është mosnjohja nga pesë vende të këtij unioni.

Kryetari i Kuvendit të Madh të Turqisë, z. Çiçek, duke ju uruar parlamentarëve të Kosovës mirëseardhje në Kuvendin e Madh të Turqisë, theksoi se marrëdhëniet midis Kosovës dhe Turqisë janë shumë të mira dhe këtë vizitë e cilësoi si mundësi shumë të mirë për thellimin e marrëdhënieve midis dy vendeve në përgjithësi e në veçanti thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy parlamenteve. Ai theksoi se Turqia do të vazhdojë të mbështesë Kosovën në të gjitha aspektet, si në vazhdimin e konsolidimit të institucioneve, ashtu edhe në zhvillimin ekonomik të saj.

Abdullah GÜL: - mbështetje të vazhdueshme në procesin e njohjeve të reja



Delegacioni parlamentar i Kosovës është pritur në një takim të veçantë nga presidenti i Republikës së Turqisë, z. Abdullah GÜL. Kryeparlamentari Krasniqi e njoftoi presidentin GÜL me zhvillimet e fundit në Kosovë, me përparimet që ka bërë Kosova dhe me sfidat me të cilat ajo po përballet, duke kërkuar vazhdimin e mbështetjes së Turqisë si në procesin e njohjeve ndërkombëtare, ashtu edhe në proceset tjera.

Presidenti GÜL theksoi se Turqia do të vazhdojë të mbështesë Kosovën edhe në të ardhmen në procesin e njohjeve, por edhe në fushat tjera.

ERDOĞAN: - Turqia përkrahje të gjithanshme ekonomike për Kosovën



Kryetari Krasniqi në fillim të takimit i bëri një vështrim të gjerë zhvillimeve aktuale në Kosovë, sidomos të arriturve që ka bërë Kosova pas shpalljes së pavarësisë. Në vijim kryekuvendari Krasniqi foli për punën që bëhet në fushën e legjislacionit sipas standardeve evropiane, si dhe për ndërtimin e institucioneve demokratike në Kosovë. Ai foli edhe për hapat që po bën Kosova në aktivitetet ndërkombëtare, si fryt i të cilave është njohja e Kosovës nga ana e 90 shteteve nga bota.

Kreu i Kuvendit i bëri një vështrim edhe çështjes së veriut, ku grupe kriminale serbe me veprimet e tyre, reflektojnë negativisht në këtë pjesë të vendit.

Kryeministri i Turqisë, z. Recep Tayyip ERDOĞAN, në fjalën e tij theksoi se Turqia do të vazhdojë të përkrahë Kosovën në të gjithë lëmenjtë. Në këtë takim një rëndësi e veçantë iu kushtua edhe bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Turqisë. Z. ERDOĞAN, në këtë aspekt theksoi se është i nevojshëm një angazhim edhe më i madh i afaristëve nga Turqia për të investuar në Kosovë, si një parakusht thelbësor për zhvillimin e mëtejshëm të Kosovës. Po kështu, kryeministri turk foli edhe për interesimin e Turqisë për të investuar edhe në lëmin e sistemit arsimor në Kosovë.

Turqia, theksoi kryeministri Recep Tayyip ERDOĞAN, do të jetë lobuese e denjë në aspektin e ndikimit tek shtetet e ndryshme të botës që ta njohin pavarësinë e Kosovës.

Parlamenti Evropian – Kosova

- Kryetari i Parlamentit Evropian, Martin Schulz;- PE-n ka lidhje të vazhdueshme me Kuvendin e Kosovës



Schulz-Krasniqi

Në të dy takimet, kryetari Krasniqi falënderoi mikpritësit për marrëdhëniet e mira që janë ndërtuar ndërmjet Parlamentit Evropian dhe Kosovës, për mbështetjen që PE-ja i ka dhënë Kuvendit të Kosovës, për qëndrimin e avancuar që ai mban ndaj Kosovës, për rezolutat e miratuara në mbështetje të saj, duke iu bërë thirrje vendeve anëtare të BE-së, të cilat nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës, që të njohin atë.

Kryetari Krasniqi shprehu shqetësimin, sidomos, ndaj qëndrimit që Serbia po mban karshi Kosovës, duke mbështetur strukturat kriminale në veri, duke mos i zbatuar marrëveshjet e arritura dhe duke shpallur zgjedhjet e saj edhe në Kosovë, vendim ky të cilin kryetari Krasniqi e quajti agresion kushtetues dhe ndërhyrje flagrante në

punët e brendshme të Kosovës.

Kryetari i Parlamentit Evropian, Martin Schulz, tha se PE-ja vazhdon të mbajë lidhje të afërta me Kuvendin e Kosovës dhe do të vazhdojë ta mbështesë atë, sikurse edhe në të kaluarën. Ai tha se perspektiva evropiane e Kosovës është e sigurtë dhe se rruga e integritit evropian të saj nuk ka asnjë kundërshtim. Megjithatë, Schulz tha se ende ka shumë punë për të bërë në këtë proces, ndërsa negociatat në këtë drejtim do të vazhdojnë.

Vendimin e Beogradit, për t'i shpallur zgjedhjet në Kosovë, ai i cilësoi në kundërshtim me negociatat e zhvilluara në Bruksel. Ndërkaq, vendimet e kohëve të fundit të Kuvendit të Kosovës, i quajti impresionuese.

PE-ja dhe Delegacioni parlamentar i Kuvendit të Kosovës dolën me një deklaratë të përbashkët, në të cilën janë sintetizuar diskutimet gjatë takimit



Pamje gjatë punimeve në Parlamentin Evropian

Punimet e takimit të përbashkët dyditor ndërmjet Parlamentit Evropian (PE) dhe Kuvendit të Kosovës, u drejtuan nga kryesues i Delegacionit të PE-n për marrëdhënie me Shqipërinë, Bosnjë - Hercegovinën, Serbinë, Malin e Zi dhe Kosovën z. Eduart Kukan. Gjatë këtyre dy ditëve u diskutuan çështje që kanë të bëjnë me progresin e Kosovës drejt integritetit evropian, për forcimin e

sundimit të ligjit dhe luftën kundër korrupsionit e krimit të organizuar, për liberalizimin e vizave, për energjinë dhe mbrojtjen e ambientit, për zhvillimin ekonomik si dhe dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Në fund të takimit, pjesëmarrësit u dakorduan për tekstin përfundimtar të një deklaratë të përbashkët.



Pamje gjatë punimeve në Parlamentin Evropian

DEKLARATË E PËRBARSHKËT E KRYESUESVE TË DELEGACIONEVE

Në mbyllje të takimit të 5-të ndër parlamentar, Parlamenti Evropian-Kosova, të mbajtur në Strasbourg më 14-15 mars 2012, dy kryesuesit:

1. Theksojnë perspektivën evropiane të Kosovës në përputhje me perspektivën evropiane të mbarë rajonit të Ballkanit Perëndimor, si stimulim i fuqishëm për reformat e nevojshme; mirëpresin propozimin së voni të zonjës Ashton dhe të Komisionarit Füle për nisjen e studimit të fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit në mes të Kosovës dhe BE-së, siç thuhet në konkluzionet e Këshillit për Çështje të Përgjithshme, më 28 shkurt 2012; mirëpresin deklaratën e Komisionarit Füle se studimi do të fillojë më 27 mars 2012, gjatë takimit të parë të Këshillit Kombëtar të Kosovës për Integritime Evropiane dhe se duhet të përfundojë më së voni në vjeshtë të vitit 2012;

2. Nënvizojnë rëndësinë e vazhdim të dialogut me Beogradin, por shprehin shqetësim për moszbatimin edhe më tej të disa marrëveshjeve që janë të rëndësishme për përmirësimin e jetesës së përditshme të qytetarëve nga të dyja anët, si dhe theksojnë se pritët nga të dyja palët që të ndjekin një qasje pragmatike e cila kërkon përkushtim, këmbëngulje dhe ndjenjë përgjegjësie në kërkimin e zgjidhjeve; mirëpresin fillimin e zbatimit të marrëveshjes për menaxhimin e integruar të kufirit (MIK) dhe inkurajojnë për përpjekje të mëtutjeshme në këtë drejtim;

3. Shprehin keqardhje për radikalizmin e mëtejshëm të situatës politike në veri të Kosovës, si rezultat i "referendumit" jo legjitim në të cilin qytetarët e veriut të Kosovës u pyetën nëse i pranojnë ose jo institucionet e Kosovës; theksojnë se ky referendum ka paraqitur një provokim; inkurajojnë qeverinë e Kosovës që të forcojë përpjekjet e saj për të qenë afër qytetarëve në veri të Kosovës;

4. Vlerësojnë progresin e arritur në sundimin e ligjit në disa fusha, siç është zhvillimi i policisë dhe i doganës; tërheqin vëmendjen për rëndësinë madhore të punës së prokurorëve dhe gjyqtarëve si dhe u bëjnë thirrje shteteve anëtare të BE-së të sigurojnë numrin e mjaftueshëm të stafit gjyqësor të EULEX-it; i bëjnë thirrje qeverisë së Kosovës që të zbatojë me shpejtësi ligjin "Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve" dhe nxisin Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS) dhe shtetet anëtare që të mbështesin EULEX-in në themelimin e mekanizmit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, përfshirë këtu zhvendosjen e dëshmitarëve; theksojnë se mungesa e një mekanizmi të tillë e zvogëlon mundësinë e EULEX-it për të proceduar me hetimet dhe ndjekjet në përgjithësi dhe më specifike, me hetimet mbi akuzat e raportit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PCAE) për trafikim të organeve;

5. Theksojnë se korrupsioni i gjerë dhe sistematik si dhe shkalla e lartë e korrupsionit vazhdon të jetë një sfidë madhore në vend, si edhe në pjesën tjetër të rajonit të Ballkanit Perëndimor, i cili minon kështu besimin e qytetarëve në sundimin e ligjit dhe ndikon në qasjen e tyre në shërbimet publike; nënvizojnë se klima ekzistuese e mosdëshkimit dhe mungesës së sanksioneve adekuate ndaj korrupsionit paraqet një nga problemet më të mëdha në Kosovë;

6. Janë seriozisht të shqetësuar për rolin që luan niveli i lartë i korrupsionit dhe krimi i organizuar në Kosovë; konsiderojnë se kapaciteti i policisë dhe gjyqësorit për luftimin e krimit të organizuar mbetet në një fazë të hershme të zhvillimit dhe u bëjnë thirrje autoriteteve në Kosovë që të ndërmarrin hapa radikalë për përmirësimin e tyre;

7. Shprehin keqardhje për ndjekjen e ngadalshme të atyre që kanë kryer shkelje zgjedhore gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare si dhe për mungesën e vullnetit politik për të vepruar me vendosmëri ndaj mashtrimeve zgjedhore; mirëpresin hapat e parë të ndërmarrë nga gjykatat ndaj atyre që i kanë kryer këto shkelje dhe theksojnë se zgjedhjet kanë shfaqur sfida të rënda për zbatimin e standardeve ndërkombëtare në këtë fushë;

8. I bëjnë thirrje Kuvendit të Kosovës për përmbushjen e procesit të reformës kushtetuese dhe zgjedhore dhe të mbajë zgjedhje të reja të përgjithshme në përputhje me rrethanat;

9. Vënë në dukje qëllimin e qeverisë së Kosovës që deri në fund të këtij viti të përmbyllë procesin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë krahas largimit relevant të Zyrës Civile Ndërkombëtare si dhe i bëjnë thirrje Kuvendit të Kosovës që në Kushtetutën e re të ruhen dhe mbrohen parimet e Planit të Ahtisaarit, të cilat e vendosën themelin e pavarësisë së Kosovës;

10. Mirëpresin progresin në reformën gjyqësore, por bëjnë thirrje për më shumë përpjekje në ngritjen e kapaciteteve dhe për të siguruar profesionalizmin e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe pavarësinë e tyre nga çfarëdo ndërhyrje politike dhe për adresimin e korrupsionit në radhët e tyre;

11. Mirëpresin faktin për fillimin eventual të dialogut për viza dhe ritheksojnë se liberalizimi i vizave varet nga kapacitetet e qeverisë së Kosovës për zbatimin e reformave substanciale në fusha kyçe; presin që udhërrëfyesi i Komisionit për liberalizimin e vizave të prezantohet në pranverën e vitit 2012.

Kosova e barabartë në procesin e integritimeve evropiane



Pamje nga takimi i Konferencës(COSAP)

Më 09.03.2012 në Tiranë janë zhvilluar punimet e Konferencës së Gjashtë të Komisioneve Parlamentare të Integritetit të Shteteve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim Asociimit (COSAP).

Punimet e Konferencës i hapi znj. Jozefina Topalli, kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë konferencë Kuvendi i Republikës së Kosovës përfaqësohet nga z. Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit për Integritime Evropiane dhe z. Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit të Kosovës dhe njëherësh nënkryetar i Komisionit për Integritime Evropiane.

Delegacioni i Kuvendit të Kosovës ka marrë pjesë në këtë konferencë për herë të parë dhe ka diskutuar i barabartë me përfaqësuesit e komisioneve homologe të vendeve të ndryshme si: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia.

Duke marrë pjesë në diskutim delegacioni nga Kuvendi i Kosovës ka theksuar se Kosova do të përfaqësohet vetëm si e

barabartë në procesin e integritimeve evropiane.

Temat e diskutuara:

- Roli dhe përgjegjësitë e Komisioneve për çështjet Evropiane në situatën aktuale të Procesit të Integritetit Evropian,
- Sfidat aktuale të MSA/ Procesi i negociatave dhe detyrat që rrjedhin për komisionet për integritime evropiane,
- Debat mbi sfidat e ardhshme dhe metodat e punës të Procesit të Stabilizim Asociimit, (COSAP-it).

Të gjitha vendet u darkorduan që të angazhohen në çështjet kryesore si:

- Bashkëpunimi në mes të komisioneve homologe parlamentare për integritime evropiane,
- Bashkëpunimi mes parlamentit dhe qeverisë për këtë proces,
- Forcimi i dialogut dhe marrëdhënie më të mira rajonale duke evituar ndasitë,
- Konkensus i brendshëm politik për këtë proces etj.

Në përfundim Konferenca miratoi një Deklaratë të përbashkët.

Kosova të jetë pjesë e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së.

Shqyrtohen modalitetet që Kosova të jetë pjesë e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së
Kosova vazhdimisht ka bërë kompromise, ndërkaq Serbia nuk ka treguar gatishmëri për implementimin e marrëveshjeve të arritura



Kraniqi - Delegacioni i parlamentarëve italianë të Asamblesë parlamentare të OSBE-së,

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti delegacionin e parlamentarëve italianë të Asamblesë së OSBE-së, të kryesuar nga Riccardo Migliori, president i delegacionit italian në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së dhe zëvendëspresident i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, në përbërje të të cilit ishin edhe on. Matteo Mecacci, president i Komisionit të Tretë (Komisioni për të Drejtat e Njeriut) në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së; sen. mauro Del Vecchio (Partia Demokratike), sen. Giuseppe Caforio (Parti e Qendrës së Majtë) dhe z. Giuseppe Maggio, këshilltar parlamentar dhe sekretar i delegacionit italian në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së.

Delegacioni falënderoi z. Krasniqi për pritjen e ngrohtë, duke i përcjellë njëkohësisht kryekuvendarit edhe përshëndetjet e homologut italian Gianfranko Fini.

Anëtarët e delegacionit treguan interesim që marrëdhëniet ndërmjet Parlamentit të Italisë dhe Kuvendit të Kosovës të intensifikohen, duke u angazhuar edhe për formimin e grupit të miqësisë në mes dy parlamenteve. Delegacioni italian theksoi se është duke shqyrtuar modalitetet që Kosova të jetë pjesë e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së. Në

këtë frymë u shtrua nevoja që Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Kosovës të krijojë një grup pune për vendosjen e marrëdhënieve të vazhdueshme me OSBE-në, me qëllim të intensifikimit të marrëdhënieve ndërmjet OSBE-së dhe Kuvendit të Kosovës. Në vijim delegacioni italian diskutoi për çështjen e zgjedhjeve parlamentare të Serbisë edhe në Kosovë, të cilat do të mbaheshin nën mbikëqyrjen e OSBE-së.

Kryekuvendari Krasniqi falënderoi delegacionin për këtë vizitë, që po i bën Kosovës, si dhe për bashkëpunimin ndërmjet Parlamentit të Italisë dhe Kuvendit të Kosovës, por edhe ndërmjet institucioneve të tjera të të dy vendeve. Në fjalën e tij, kryekuvendari Krasniqi theksoi se Kosova vazhdimisht ka bërë kompromise që nga Rambujeja e deri në bisedimet e Brukselit, ndërsa Serbia nuk ka treguar gatishmëri për implementimin e marrëveshjeve të arritura.

Kryetari i Kuvendit Krasniqi kërkoi që parlamentarët italianë të ndikojnë, që Kosova të jetë pjesë e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së. Gjithashtu, z. Krasniqi tha se shumë shpejt do të formohet Grupi i Miqësisë Kosovë-Itali.

Takim i Komisionit për Punë të Jashtme me delegacionin e parlamentarëve italianë të OSBE-së

Shqyrtohen modalitetet që Kosova të jetë pjesë e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së

Kosova vazhdimisht ka bërë kompromise, ndërkaq Serbia nuk ka treguar gatishmëri për implementimin e marrëveshjeve të arritura



Takim i Komisionit për Punë të Jashtme me delegacionin e parlamentarëve italianë të OSBE-së

Anëtarët e Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë pritur në një takim delegacionin italian në Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, i kryesuar nga Riccardo Migliori, president i këtij delegacioni dhe zëvendës-president i kësaj asambleje.

Kryetari i Komisionit, Albin Kurti, i cili e ka drejtuar takimin, ka falënderuar popullin dhe shtetin italian për mbështetjen e vazhdueshme dhënë Kosovës dhe për njohjen e pavarësisë së vendit tonë. Ai ka folur për sfidat me të cilat ballafaqohet shteti i ri i Kosovës, si dhe për nevojën e ngutshme për zhvillim ekonomik të vendit, për më shumë njohje dhe sovranitet. “Deputetët e Kuvendit të Kosovës mund të dallojmë për çështje të ndryshme të rreth politikave zhvillimore të vendit, por jemi unikë për sa i përket integriteteve evropiane”, ka thënë Kurti. Ai ka vlerësuar rolin e OSBE-së në Kosovën e pasluftës, por ka theksuar edhe vështirësitë e saj, kur vepronte si Shtyllë III e UNMIK-ut.

Kryesuesi i delegacionit italian në Asamblesë

Parlamentare të OSBE-së dhe zëvendës-president i kësaj asambleje, Riccardo Migliori, ka shprehur interesimin e Parlamentit italian për thellimin e bashkëpunimit me Kuvendin e Kosovës, dhe sidomos interesin e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së që të dëgjohet edhe zëri i Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me vendin tonë, por edhe për çështjet e rajonit. Ai ka pohuar se vendi i tij ka politikë të jashtme unike, e cila mbështetet në premisat e të qenit anëtar i NATO-s, anëtar e BE-së, si dhe në konsideratën për të qenit faktor në Mesdhe. Duke e vlerësuar rolin e diplomacisë parlamentare për afirmimin ndërkombëtar të një vendi, Migliori, ka shprehur nevojën që të krijohen grupe funksionale ndërparlamentare të miqësisë, si dhe për krijimin e një grupi ad-hoc që do të komunikonte me Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, si dhe me delegacionet e parlamenteve të vende anëtare, në mënyrë që të dëgjohet edhe zëri i Kosovës dhe që, në një të ardhme jo të largët, edhe Kosova të bëhet anëtare e kësaj asambleje.

Veriu i Kosovës thërret Kuvendin në seancë të jashtëzakonshme

Kuvendi i Republikës së Kosovës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 18.04.2012, drejtuar nga dr. Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, ka debatuar lidhur me gjendjen në Veri të Kosovës. Seanca është thirrur sipas kërkesës së nënshkruar nga 46 deputetë të Grupit Parlamentar i PDK-së dhe deputetë të tjerë nga radhët e koalicionit qeverisës.

Arsyetimin e kërkesës për seancë të jashtëzakonshme e ka paraqitur kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci. Ai ka theksuar gjendjen e përkeqësuar në veri të Kosovës për shkak të veprimeve kriminale të strukturave paralele

të Serbisë që kulmoi me aktin terrorist ndaj familjes së Selver Haradinajt. Ai është shprehur i bindur se edhe ky debat parlamentar do të ndikojë që gjendja veri të vihet nën kontroll dhe të sigurohet jeta e qytetarëve, pa dallim etnie, që jetojnë atje.



Fjala e ministrit të brendshëm, Rexhepi

Ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, situatën e sigurisë në Kosovë ka vlerësuar të qetë, me përjashtim të veriut të vendit, ku situata mbetet e tensionuar në planin politik dhe të sigurisë. Ai ka pohuar se, me gjithë veprimet e kriminelëve dhe strukturave paralele serbe, situata po mbahet nën kontroll nga forcat e sigurisë në Kosovë (Policia e Kosovës, EULEX-i dhe KFOR-i). Përgjegjës të drejtpërdrejtë të gjendjes në veri të Kosovës, Rexhepi i ka quajtur institucionet shtetërore të Serbisë, të kapluara nga ethet elektorale. Ai në vazhdim ka shkoqitur gjithë pasqyrën e krimit të kryer ndaj familjes Haradinaj dhe konstatimet e ekspertëve të policisë së Kosovës për krimin e kryer: vrasjen kryefamiljari, Selverit, 38 vjeçar dhe plagosjen e fëmijëve të tij, nga shpërthimi me 500 gram eksploziv. Ai ka folur edhe për vendosjen e pikës statike (kontejnerit) të Policisë së Kosovës, në lagjen "Tre rrokaqiejt",

e cila gjithashtu është demoluar nga rreth 200 protestues serbë, si dhe për tërheqjen e përkohshme të patrullës në këtë lagje. Rexhepi ka theksuar se Policia ka dokumentacion të mjaftueshëm për kryerësit e këtij akti.

"Policia e Kosovës ka kapacitete dhe e ka autoritetin për ta siguruar jetën e qytetarëve në veri", i ka garantuar ministri i Brendshëm deputetët e Kuvendit të Kosovës. Ai u shpreh se qeveria dhe ministria, të cilën e udhëheq, parimisht parapëlqen koordinimin me EULEX-in dhe KFOR-in për të vënë rend dhe ligj në pjesën veriore të vendit, por nëse kjo nuk bëhet nivelin e duhur, ka tërhequr vëmendjen ai, atëherë do të ndërmerren e nevojshme legale për ta siguruar jetën dhe lirinë e lëvizjes së qytetarëve, por edhe për të penguar mbajtjen e zgjedhjeve lokale serbe, nëse tentohet të mbahen në Kosovë.

"LDK-ja po i ndjek me vëmendje dhe shqetësim zhvillimet në veri të vendit", ka thënë shefi i këtij grupi parlamentar, Ismet Beqiri. Ai ka thënë se gjendja në veri jo që është stabilizuar, siç ka premtuar Qeveria tash e shtatë vjet, por ajo sa vjen e përkeqësohet. "Qeveria i ka të përcaktuara obligimet e saj, por po i mungojnë rezultatet dhe vullneti për t'i përmbushur ato", ka theksuar. Beqiri, i cili është shprehur edhe kundër bisedimeve me Serbinë, në mënyrën si janë zhvilluar ato. "Banorët e veriut kanë nevojë për siguri, kanë nevojë për dorën e shtetit", ka përfunduar ai.

"Në kohën kur strukturat ilegale serbe vritnin shqiptarë dhe i dëbonin nga pronat e tyre, kryeministri i Kosovës, vazhdonte ligjëratat e tij në Amerikë, pa vrarë mendjen se ç'po ndodhte në vend", ka thënë kryetari i Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Visar Ymeri, i cili e ka ironizuar mbajtjen e vonuar të kësaj seance, e cila ka mundur të thirrej me kohë nga vetë kryeministri. Ai tërheqjen hap pas hapi të

Qeverisë nga veriu e ka quajtur si të menduar, duke theksuar se të ashtuquajturat bisedimet me Serbinë vetëm sa i kanë trimëruar strukturat serbe në veri. Prandaj, ka kërkuar ai: duhet të ndërpriten këto bisedime, duhet të hetohen dhe të ndërpriten burimet financiare të këtyre strukturave. "Paqe do të ketë vetëm me vendosjen e reciprocitetit të plotë të Kosovës dhe Shqipërisë me Serbinë, ka thënë Ymeri.

Kryetar i Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, ka pohuar se probleme nuk ka vetën në veri, por në gjithë Kosovën, duke pohuar se kjo qeveri ka dështuar në çdo aspekt të veprimit të saj. Duke konstatuar se gjendja është më e keqe se para katër vjetësh, se strukturat paralele janë më të forta se kurrë dhe se në Mitrovicë ka më pak shqiptarë se më parë, ai ka tërhequr vëmendjen se Kosova po rrezikon ta humbas investimin njëqindvjeçar për pavarësi, prandaj ka kërkuar dorëheqjen e Qeverisë.



Pamje nga salla gjatë seancës së Jashtëzakonshme

Shefja e Grupit Parlamentar të KKR-së, Myzejene Selmani, ka kërkuar veprim të përbashkët i Qeverisë, BE-së, SHBA-ve, EULEX-it dhe KFOR-it që ta shtrijnë veprimin e tyre në veri të vendit, për sigurinë e qytetarëve dhe për zbardhjen e krimeve dhe të aktiviteve të tjera të paligjshme. Ajo tërhoqi vëmendjen se nëse luajnë kufijtë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, do t'i kushtojë shtrenjtë krejt Ballkanit.

Duke folur në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nënkryetari i Kuvendit, Petar Miletiq, ka shfaqur brengosjen e tij për mënyrën se si po bisedohet për veriun dhe për gjuhën e

përdorur që, siç shprehur ai, ka për qëllim fyerjen e qytetarëve të një nacionaliteti që jeton në Kosovës dhe përcimin me mesazheve politike dhe patriotike. "Problemi i sigurisë në veri është vetëm reflektim i problemit të pazgjidhur politik atje", ka pohuar ai.

Albert Kinolli, shef i Grupit Parlamentar 6+, ka shprehur brengosjen e tij për faktin që përkeqësimi i gjendjes në veri nuk po u bën shumë përshtypje faktorëve ndërkombëtarë që kanë marrë përgjegjësi për sigurinë në Kosovë dhe sundimin e rendit dhe të ligjit. Ai i ka lutur përfaqësuesit e këtyre faktorëve që të mos provokohet durimi i qytetarëve të Kosovës.

Në emër të Qeverisë së Kosovës, seancës i është drejtuar zv.kryeministri, Hajredin Kuçi, i cili është përqendruar në veprimet që i ka marrë dhe do t'i marrë ekzekutimi i vendit për stabilizimin e gjendjes në veri, për shtimin e besimit të qytetarëve tek institucionet e Kosovës, për qartësimin e qytetarëve për perspektivën e tyre dhe për statusin shtetëror të Kosovës. "Veprimet legale që do t'i

ndërmarrim duhet të jenë të pranueshme nga qytetarët serbë", ka theksuar Kuçi, duke i ftuar EULEX-in dhe KFOR-in që të jenë më aktiv në veri. Duke pasur parasysh kryesit e veprave kriminale në veri, zv. kryeministri i garantuar deputetët dhe qytetarët e Kosovës se drejtësia mund të vonohet por se ajo një ditë do të veprojë.

Deputetët e shumtë, nga radhët e të gjitha grupeve parlamentare, të cilët kanë folur në seancë, janë pajtuar për gjendjen e rëndë të sigurisë në veri të vendit, por janë dalluar në qëndrimet e tyre për shkaqet dhe shkaktarët e kësaj gjendje.



Pamje nga salla gjatë seancës së Jashtëzakonshme

Deputetët e opozitës, në bllok, kanë qëndruar në mendimin se Qeveria e Kosovës, jo vetëm ka dështuar të sigurojë ambient të sigurt në veri dhe perspektivë zhvillimi për qytetarët e atjeshëm, por kanë pobuar, se asaj i mungon dija, vullneti dhe përkushtimi për ta bërë këtë. Deputetët nga koalicioni qeverisës kanë theksuar se gjendja në veri është trashëguar që nga paslufta dhe se për këtë janë përgjegjëse të gjitha qeveritë e shkuara, gjithë klasa politike e Kosovës, si dhe faktorët ndërkombëtarë në Kosovë që kanë marrë përgjegjësi për sigurinë dhe sundimin e rendit dhe të ligjit.

Gati në përfundim të debatit fjalën e ka marrë kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, i cili i ka siguruar deputetët dhe qytetarët e Kosovës se me gjithë problemet në veri, pavarësia dhe sovraniteti i Kosovës janë të garantuar. "Qytetarët e Kosovës dhe të gjithë Ballkanit kanë përjetuar mjaft dhunë dhe trauma, prandaj detyrë e liderëve të përngjeshëm është që t'i përmbyllin dhe jo t'i ringjallin ato", ka theksuar ai. "Vendosja e rendit dhe ligjit në veri të Kosovës nuk nënkupton pushtim të tyre nga shqiptarët as asimilim, por nënkupton integritet dhe jetë më të mirë për qytetarët", është shprehur kryeministri. Kidnapimin, ndërkaq, të dy policëve të Kosovës në territorin e Kosovës e ka quajtur akt të dënueshëm nga qytetarët e Kosovës dhe nga opinioni botëror. Cenimi, qoftë edhe i një centimetri katror të Kosovës ka merituar përgjigje të meritueshme ndaj Xhandarmerisë serbe, është shprehur i prerë Thaçi. Ai ndërkaq i ka akuzuar deputetët nga radhët e opozitës për deklarata nxitëse, duke akuzuar për krim një komunitet të tillë, siç po veprohet ngjashëm në Maqedoni kundër shqiptarëve pas vrasjes së pesë qytetarëve maqedonas. Kritikën e opozitës ndaj qeverisë, i ka vlerësuar, ndërkaq, zhurmë elektorale.

Konferenca e Asamblesë Parlamentare e NATO -s “Mbrotjtje e zgjuar”

Tiranë, 23 prill. Nën organizimin e Kuvendit të Shqipërisë në bashkëpunim me Asamblenë Parlamentare të NATO-s, në Tiranë, ka filluar konferenca treditore me temë: “Mbrotjtje e zgjuar - bashkëpunimi dhe koordinimi rajonal midis vendeve të Evropës Juglindore, grumbullimi dhe ndarja e aseteve të mbrotjtjes”.



Konferenca e Asamblesë Parlamentare e NATO-s.

Në konferencë marrin pjesë delegacionet në Asamblenë Parlamentare të NATO-s nga Shqipëria, Austria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Kroacia, Hungaria, Italia, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Sllovenia, Turqia. Në këtë konferencë mori pjesë edhe një delegacion nga Kuvendi i Kosovës, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Petar Miletiq dhe Ahmeti Isufi. Të pranishëm në këtë konferencë janë edhe

zëvendëssekretari i përgjithshëm i NATO-s, dr. Karl Lamers, presidenti i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, David Hobbs, ambasadorët e akredituar në Tiranë, ministra shqiptarë etj.

Në ditën e parë të konferencës, fjalën përshëndetëse e mbajti kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli, e më pas kryeministri Sali Berisha, si edhe David Hobbs, Sekretari i Përgjithshëm i Asamblesë Parlamentare të NATO-s.

Kryetari i delegacionit të Kuvendit të Kosovës z. Xhavit Haliti, nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka marrë fjalën në konferencën “Mbrotjtje e Zgjuar”.

Kosova i mbështet objektivat e NATO-s

Ndihem i nderuar për praninë në këtë konferencë dhe që më jepet mundësia të flas para jush si përfaqësues i delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s. Në këtë cilësi, pra si përfaqësues i shtetit më të ri, jo vetëm ndër vendet e Evropës Juglindore, por dhe më gjerë, dua të vë në dukje qysh në fillim dy veçori:

Së pari, Kosova fitoi lirinë me ndihmën e fuqishme

të drejtpërdrejt të NATO-s. Së dyti, forcat e NATO-s vazhdojnë të jenë të pranishme dhe vepruese në mbështetje të konsolidimit të shtetit dhe të sigurisë së stabilitetit të Kosovës. Jemi mbledhur këtu në funksion të konceptit të ri strategjik të NATO-s për të arritur zgjedhjen me sukses të sfidave të shekullit 21 nga liderët e Aleancës në Samitin e Çikagos.

Në këtë kuadër kjo konferencë synon të përballojë burimet e kufizuara përmes grumbullimit dhe ndarjes së aseteve të mbrojtjes, të specializimit, të bashkëpunimit dhe të koordinimit në nivel rajonal. Trajtimi dhe përcaktimi i rrugëve efektive për realizimin e këtij objektivi në nivel rajonal, mendoj se kanë si fillesë të domosdoshme e të pashmangshme normalitetin dhe besueshmërinë në raportet shtetërore bilaterale dhe multilaterale. Po kjo premisë, e pranishme dhe vepruese te shumica e vendeve të Evropës Juglindore, nuk shfaqet e tillë te shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Mendoj se nuk kanë shumë rëndësi arsyet e diferencave ndërmjet shteteve të rajonit, që dihet se janë historike, politike, gjeostrategjike, se sa mundësitë reale të Kosovës për të kontribuar në grumbullimin dhe ndarjen e aseteve të mbrojtjes në funksion të “Mbrojtjes së Zgjuar”. Deklarohet dhe kërkohet që kjo mbrojtje të arrihet përmes bashkëpunimit rajonal ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore. Por, në këtë rajon bëjnë pjesë edhe shtete që vazhdojnë të insistojnë për mosnjohjen e shtetit të Kosovës. Dhe, për fat jo të mirë, me këto vende jemi gjeografikisht dhe historikisht më afër sesa një numër shtetesh të

tjerë të rajonit.

Dihen raportet problematike midis shteteve, që u formuan pas prishjes së Jugosllavisë. Dihet prania e forcave të NATO-s në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë dhe arsyeja e kësaj pranie. Dihen përpjekjet dhe hapat e ndërmarrë nën kujdesin dhe ndërmjetësimin e BE-së, për shmangien e situatave konfliktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për zgjidhjen e problemeve teknike midis dy shteteve, që shpresoj dhe dëshiroj t'u paraprijnë dhe t'i shërbejnë normalizimit të marrëdhënieve tona. Dihen gjithashtu efektet negative të shfaqjeve demonstrative të nacionalizmit dhe ultranacionalizmit në stabilitetin dhe prosperitetin shtetëror dhe ndërshtetëror të disa vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe sidomos ndërmjet Kosovës e Serbisë.

Aktualisht situata në Mitrovicën e Veriut është kërcënuese. KFOR-i dhe EULEX-i po përpiqen dhe po kontribuojnë që ajo të mbetet nën kontroll. Qeveria e Kosovës, në respekt dhe zbatim të marrëveshjeve të arritura në Bruksel me Serbinë, po kufizohet në kuadër të reagimeve deklarative për të shmangur çdo incident të mundshëm më pakicën serbe dhe çdo keqkuptim me Beogradin.



Konferenca e Asamblesë Parlamentare e NATO-s.

Kjo vetëpërmbytje përveç përgjegjshmërisë së institucioneve shtetërore të Kosovës për të ruajtur qetësinë dhe stabilitetin social, kushtëzohet dhe nga prania dhe roli aktiv i ndërkombëtarëve. Pakica serbe respekton, për të mos thënë që i nënshtrohet më tepër autoritetit të KFOR-it. Qeveria serbe njeh vetëm KFOR-in, duke injoruar çdo faktor mbrojtës shtetëror të Kosovës. Ndërkohë, është deklaruar zyrtarisht nga autoritetet tona shtetërore dhe është mirëpritur ndërkombëtarisht që gjatë këtij viti merr fund pavarësia e mbikëqyrur e Republikës së Kosovës. Shpresoj të më keni mirëkuptuar për sa fola. U përpoqa të parashtroj statusin aktual të Republikës së Kosovës në Ballkanin Perëndimor dhe rrjedhimisht edhe vendin që ajo zë në rajon dhe kontributin që ajo mund të japë realisht në përballje me burimet e kufizuara përmes grumbullimit dhe ndarjes së aseteve të mbrojtjes,

të specializimit, të bashkëpunimit dhe të koordinimit në nivel rajonal. E kam pasur dhe vazhdoj të kem mendimin që mbrojtja e shtetit të Kosovës është kërcënuar nga jashtë dhe nga brenda. Nuk pretendoj të kem argumente bindëse, por dhe nuk dëshiroj të akuzoj askënd për këtë situatë. Kam bindjen se institucionet përkatëse shtetërore kanë predispozitën, dëshirën dhe aftësinë të ruajnë stabilitetin shtetëror dhe paqen e mirëkuptimit ndërshtetëror.

Në mbyllje të fjalës dua të theksoj: Sot, në këtë konferencë, Republika e Kosovës gjen mundësinë të deklarohet se është shteti më i interesuar në Ballkanin Perëndimor për realizimin e objektivave të kësaj konference dhe për miratimin unanimit nga të gjithë pjesëmarrësit e draft-deklaratës që na është parashtruar.

Ju faleminderit

Presidenti tashmë nga populli



Pëfundon komisioni Ad - hoc, për amendamentet kushtetuese

Kryetari i Komisionit për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, z. Arsim Bajrami, i shoqëruar nga nënkryetarja e këtij Komisioni , Vjosa Osmani, në mënyrë solemne i dorëzoi Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi gjithë dokumentacionin përfundimtar të Komisionit ad – hoc, të cilat mundësojnë tashmë zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit.

Mblidhet Këshilli Kombëtar për Integrim Evropian

E ardhmja e rajonit në Evropën e bashkuar- garanci për jetë në paqe dhe mirëqenie

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, mori pjesë në takimin inauguroes të Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian, të kryesuar nga presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga. Kryekuvendari Krasniqi iu drejtua të pranishmëve me këto fjalë :”

E nderuar presidente Jahjaga
I nderuar kryeministër Thaçi
I nderuar zoti Fyle
I nderuar zoti Zhbogar
I nderuar zoti Mustafa
Zonja dhe zotërinj



Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian

Që nga fillimi i zbatimit të idesë së Bashkimit Evropian, tash e mbi 60 vjet më parë, Evropa i solli vetes paqe e siguri të qëndrueshme, stabilitet, zhvillim demokratik e ngritje të fuqishme ekonomike. Shumë vende evropiane të pa aderuar në këtë bashkim, duke përfshirë edhe rajonin tonë, e kthyen në ideal integrimin e tyre evropian, si mundësi stabiliteti, bashkëpunimi dhe prosperiteti. Procesi i Stabilizim-Asociimit, ka bërë transformime të mëdha në vendet e rajonit dhe ka ndryshuar filozofinë politike të tyre, duke i sjellë më afër Evropës dhe duke konsoliduar demokracinë e brishtë. Filozofia politike e Bashkimit Evropian është bashkëjetesa dhe zgjidhja e të gjitha problemeve në rrugë paqësore e me mjete demokratike. E ardhmja e rajonit tonë në Evropën e bashkuar, nuk do të thotë vetëm hyrje në familjen e popujve të integruar, por edhe garanci për një jetë në paqe dhe mirëqenie.

Republika e Kosovës, me konsensus të plotë, është e përcaktuar jetësisht për integrimet euroatlantike. Me Evropën dhe Perëndimin në përgjithësi, ne na lidh e kaluara, na lidh e sotmja dhe do të na lidhë akoma më shumë e ardhmja. Vlerat evropiane në Kosovë kanë jetë më të gjatë, por procesi i përafrimit me Bashkimin Evropian, zyrtarisht ka filluar në nëntor të vitit 2002, nëpërmjet të Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim-Asociimit.

Që nga ajo kohë, në Kosovë dhe për Kosovën kanë ndodhur ngjarje të rëndësishme për integrimin e saj evropian, si Samiti i Selanikut, fillimi i Partneritetit Evropian për Kosovën, hapja e Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, hartimi dhe publikimi i Raporteve të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, gatishmëria e BE-së për të asistuar zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës, Misioni për sundimin e ligjit në Kosovë (EULEX) dhe Zyra e Përfaqësuesit Special të BE-së, Plani për Integrim Evropian 2008-2010, Konferenca e Donatorëve për Kosovën, e drejtuar nga Komisioni Evropian, fillimi i procesit të Liberalizimit të Vizave për Kosovën, dialogu i Procesit të Stabilizim Asociimit, miratimi nga Qeveria e Prioriteteve Strategjike për Integrim Evropian, themelimi i Ministrisë së Integritimit Evropian, fillimi i përgatitjeve për Marrëveshjen Tregtare në mes të BE-së dhe Kosovës, takimet e

shumta sektoriale në kuadër të procesit të Stabilizim - Asociimit, nënshkrimi i projekteve të përbashkëta me Shqipërinë dhe Maqedoninë për Bashkëpunim Ndërkufitar dhe marrëveshja me Serbinë për Menaxhimin e Integruar të Kufijve, emërimi i zotit Zhbogar si përfaqësues special dhe shef i Zyrës së BE në Kosovë, si dhe premtimet për qartësimin e perspektivës evropiane të Kosovës, të marrëdhënieve kontraktuale, procesit të liberalizimit të vizave etj.

Në janar të vitit 2008 në Kuvendin e Kosovës është formuar Komisioni për Integrim Evropian, i cili ka përgatitur për miratim dokumente strategjike të integritimit evropian dhe plane veprimi për zbatimin e tyre. Janë mbajtur katër takime të rregullta midis Parlamentit Evropian dhe Kosovës, para shpalljes së pavarësisë dhe pesë të tjera pas saj. Takimi i fundit i para dhjetë ditëve në Strasburg, ri konfirmoi qëndrimin e avancuar të Parlamentit Evropian karshi Kosovës dhe pavarësisë së saj si dhe thelloi marrëdhëniet e shkëlqyera midis Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Kosovës. Unë dëshiroj të falënderoj edhe njëherë zotin Štefan FÜLE, Komisioner për Zgjerim dhe Politika të Fqinjësisë, në Komisionin Evropian për pjesëmarrjen në atë takim dhe për prezantimin e shkëlqyeshëm të tij. Kuvendi i Kosovës ka miratuar një kornizë të tërë ligjore, sipas standardeve evropiane, duke u kthyer kështu në një faktor të rëndësishëm të integritimit evropian të Kosovës.

Shpallja sot e formimit edhe të një mekanizmi nacional të Kosovës për integrimin evropian, dëshmon përkushtimin e institucioneve tona në këtë proces kaq të rëndësishëm për të sotmen dhe të ardhmen e vendit tonë. Ne jemi të ndërgjegjshëm për punën e madhe dhe komplekse, që kemi përpara për përmbushjen e standardeve evropiane, të kritereve politike, e ekonomike dhe instrumenteve të përcaktuara nga Kopenhagen, Zagrebi, Selaniku etj., por një organizim dhe koordinim i vazhdueshëm e i gjithanshëm do të mundësojë realizimin e ëndrrës evropiane të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Kosova e meriton dhe do të jetë anëtare dinjitoze e familjes së integruar evropiane. Ajo nuk duhet të jetë më peng i askujt. Faleminderit”!

Kuvendi zyrtarizoi themelimin e Zyrës për Hulumtime Parlamentare

Kjo është një mundësi e veçantë për demokracitë parlamentare që degës së legjislativit t'i ofrohet një fuqi e vërtetë, tha Dean



Pamje nga takimi

Në një takim të përbashkët të kryetarëve të komisioneve parlamentare, në të cilin merrnin pjesë edhe kryetari Kuvendit dr. Jakp Krasniqi dhe anëtari i Bordit të NDI-së, Howard Dean, u zyrtarizua themelimi i Zyrës për Hulumtime Parlamentare.

Duke folur për rëndësinë e kësaj Zyre, kreu i Kuvendit, fillimisht falënderoi NDI-në dhe USAID-in, Ambasadën Amerikane dhe institucionet e tjera që e kanë ndihmuar Kuvendin e Kosovës në procesin e ndërtimit dhe të demokratizimit të jetës parlamentare në Kosovë. Kjo ndihmë, tha ai, ka avancuar shumë punën e Kuvendit, ndërkaq, në vazhden e përpjekjeve tona për të fuqizuar Kuvendin dhe kapacitetet e tij, si politike, ashtu edhe profesionale, Kuvendi ka qenë i përqendruar në tri fusha kryesore: fuqizimi i Kuvendit politikisht, fuqizimin e kapaciteteve profesionale të administratës dhe rritjen e transparencës. Për sa i përket Zyrës për Hulumtime Parlamentare, kreu i

Kuvendit e vlerësoi atë të rëndësisë së veçantë, dhe shprehu bindjen se ajo do të ndikojë në nxjerrjen e ligjeve më cilësore, ndërsa, deputetët për mes saj do të jenë më shpejtë dhe më saktë të informuar për materien që atyre do tu interesojë. “Drejtoria për Hulumtime Parlamentare pritet të plotësohet me staf të ri, dhe numri i zyrtarëve të saj do të rritet në vazhdimësi për të qenë në funksion të përmbushjes së kërkesave të Kuvendit dhe të deputetëve”, tha kryeparlamentari Krasniqi. Kreu i Kuvendit, në vijim foli për objektivat dhe punën e Kuvendit, me ç’rast përkujtoi se brenda vitit në Kuvendin e Kosovës miratohen deri në 100 ligje.

Përfaqësuesi i NDI-së, Howard Dean, duke folur për rëndësinë e kësaj zyre, fillimisht përgëzoi për themelimin e saj. “Kjo është një mundësi e veçantë për demokracitë parlamentare që degës së legjislativit t'i

ofrohet një fuqi e vërtetë”, tha Dean. Shërbimi për hulumtime parlamentare do tu mundësojë deputetëve dhe Kuvendit që të kenë në dorë informatat e duhura, tha ai. Në vijim, Dean i bëri një vlerësim punës së Kuvendit nga vizita e tij vitin e kaluar. “Ju jeni duke e ndërtuar një demokraci të shkëlqyeshme këtu, dhe jeni duke punuar mjaft mirë”, tha ai.

Për planet e administratës, foli sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi. Ai me këtë rast vuri në pah përpjekjet e vazhdueshme për avancimin e kapaciteteve profesionale të administratës në mënyrë që të përballlet me sukses me kërkesat e deputetëve.

Për sa i përket Zyrës për Hulumtime Parlamentare, sekretari i Kuvendit njoftoi se stafi i saj fillimisht do të përbëhet prej katër anëtarëve, të cilët do të fillojnë të punojnë nga një gushti, ndërkaq, në fillim të shtatorit do të jenë të gatshëm të pranojnë kërkesat për hulumtim sipas nevojave të deputetëve dhe Kuvendit. Sekretari i Kuvendit, po ashtu tha se stafi i kësaj Zyre do të plotësohet në vijimësi, derisa të arrijë që të jetë e gatshme të përballlet me kërkesat që do t'i adresohen. Për aktivitetin e Departamentit Ligjor, të pranishmit i njoftoi drejtori i këtij departamenti, Daut Beqiri. Ky departament, tha ai, ofron këshilla juridike dhe informata për deputetët dhe anëtarët e komisioneve. Beqiri, po ashtu tha se deri tani ky departament me sukses ka kryer obligimet e veta ndaj deputetëve.

Për rëndësinë e kësaj Zyre folën edhe deputetët, përkatësisht, kryesuesit e komisioneve: Albin Kurti, Armend Zemaj, Florin Krasniqi e Ali Sadriu. Ata përgëzuan për hapjen e kësaj Zyre, dhe shprehën besimin se do të jetë në funksion të një pune më të mirë dhe më të efektshme të komisioneve. Të njëjtin opinion shprehën edhe përfaqësuesit e Institutit GAP dhe ata të Qendrës për Politikë dhe Avokim.

Komisioni për Integritet Evropiane thërret në raport:

Ministrin e Drejtësisë z. Hajredin Kuçi,

Komisioni për Integritet Evropiane, ka filluar me monitorim aktiv të ministrive, mbi progresin e arritur. Komisioni do të bëjë vlerësimin e progresit të arritur në bazë të agjendës evropiane. Kjo, sipas kryetarit të këtij komisioni lidhet me përgatitjen e raportit të parë për këtë vit, nga ana e Kuvendit të Kosovës.



Ministrit të Drejtësisë Kuçi - Komisioni për Integritet Evropiane

Zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, raportoi në Komisionin për Integritet Evropiane. Me këtë rast ai tha se janë bërë ndryshime në kompetencat dhe në përbërjen e gjyqtarëve në Dhomën e Veçantë, është zvogëluar numri i gjyqtarëve të EULEX-it, ndërkohë është rritur numri i gjyqtarëve vendor. Më tej ai shtoi se MD-ja po përpaketon që të krijojë kushte edhe më të mira gjyqësorin, ndërsa theksoi se mosfunksionimi i gjykatave në veri ndikon në shkeljen e lirisë dhe të drejtave të njeriut.

“Sa i përket Raportit të Progresit, për vitin 2011, si Ministri i Drejtësisë, jemi ndarë të kënaqur me ndryshimet pozitive, të cilat janë realizuar, por natyrisht ka edhe sfida tjera. Kemi ndërmarrë veprime në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe në koordinim të plotë për fushën e rendit dhe ligjit me EULEX-in, meqë jemi në bordin për sundimin e rendit dhe ligjit, ku marrin pjesë përveç përfaqësuesve të EULEX-it edhe përfaqësues të Ambasadës Amerikane dhe të Komisionit Evropian. Andaj, fokusi i veçantë në këtë bord ka të bëjë me Raportin e Progresit të KE-së.”, tha fillimisht zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, gjatë raportimit të tij në Komisionin për Integritet Evropiane.

Ministri Kuçi tha se vitin e kaluar janë bërë ndryshime në kompetencat dhe në përbërjen e gjyqtarëve në Dhomën e Veçantë, dhe se është zvogëluar numri i gjyqtarëve të EULEX-it, ndërkohë është rritur numri i gjyqtarëve vendor.

Janë ndërmarrë hapa të veçantë për divizionin për integritet gjyqësor dhe se ky divizion në tërësi është bartur në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mënyrë që të jetë më efikas.

Projektligji për Akademinë e Drejtësisë, Projektligji për

Avokaturën Shtetërore, ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Procedurën Përmbarimore, Projektligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, Projektligji për konfiskimin e pasurisë së fituar përmes veprës penale, ndryshimi dhe plotësimi i Kodit të Procedurës Penale, ndryshimi i Projektligjit për noterinë, Projektligji për kundërvajtje, ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Gjykatat, i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, për atë Prokurorial, Prokurorinë e Shtetit, si dhe Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, janë ligjet të cilat janë paraparë për procedim gjatë këtij viti. Z. Kuçi, kërkoi mbështetje nga komisioni parlamentar për integritet evropiane, që në Komisionin Kushtetues të vihet edhe neni ku parasheh Ligjin për Amnistinë. Ai theksoi se MD-ja ka filluar edhe me krijimin e kushteve më të mira për gjyqtarët dhe prokurorët. Shërbimi Korrektues përballët me vështirësi për sigurimin e fondeve për riparime, por mesatarisht sipas tij kushtet në shërbimin korrektues në Kosovë, janë të përafërta me vendet e rajonit.

Duke folur për Kodin e ri Penal, ai sqaroi se MD-ja përmes një shkrese ka kërkuar nga Komisioni për Legjislacion, që të hiqet neni 37, si dhe të modifikohet neni 38, që ka të bëjë me punën e gazetarëve.

Duke iu përgjigjur pyetjeve të anëtarëve të komisionit, ministri Kuçi tha se MD-ja përpaketon që të krijojë kushte edhe më të mira për funksionimin e gjyqësorit dhe prokurorisë që t'i kryejë detyrat e veta për infrastrukturën ligjore, në kuadër të sistemit të drejtësisë dhe të jap kontributin e vet që rendi dhe ligji të përmirësohet, në përputhje me standardet që kërkohen për integritet evropiane, të cilat janë funksionale për Kosovën dhe qytetarët e saj.

Anëtarët e Komisionit, Lutfi Haziri, Blerim Shala,

Vjosa Osmani, Albert Kinolli dhe Blerta Deliu, kërkuar sqarime të shumta nga ministri Kuçi, me theks të veçantë lidhur me çështjen e gjykatave në Veri, praninë ndërkombëtare në fushën e gjyqësorit, dëshmitarët e mbrojtur, rreth procesit të përfundimit të Pavarësisë së Mbikëqyrur, etj.

Lidhur me funksionalitetin e gjyqësorit në tërësi në Kosovë, ministri Kuçi theksoi se MD-ja ka vënë tri kushte për këtë: sistemi të jetë unik anë kënd Republikës së Kosovës, të ketë ligje të aplikueshme të njëjta në të gjithë vendin, si dhe të ketë hierarki të emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga KGJK-ja.

Ai shtoi se mosfunksionimi i gjykatave në veri ndikon në shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Sa i përket procesit të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur, ministri Kuçi tha se prania e misionit civil ndërkombëtar do të përfundojë brenda këtij viti, ndërsa në tranzicion mbetet prania e EULEX-it.

Kryetari i Komisionit për Integritet Evropian, Lutfi Haziri, sqaroi se Komisioni do të paraqesë në seancë plenare Planin e Veprimit të realizuar për tre mujorin e parë, për të parë progresin dhe sfidat që ka identifikuar edhe kjo ministri.

Ministrin e Brendshëm, z. Bajram Rexhepi,



Ministri i Brendshëm, z. Rexhepi - Komisioni për Integritet Evropian

Në mbledhjen e Komisionit për Integritet Evropian, të kryesuar nga kryetari i komisionit, Lutfi Haziri, raportoi ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi. Gjatë këtij takimi, nga ministri i Punëve të Brendshme u kërkuar sqarime të shumta lidhur me progresin e arritur nga kjo ministri, me theks të veçantë për angazhimet në sigurinë e dokumenteve, menaxhimin e integruar të kufijve, politikën e migracionit, si dhe për angazhime tjera konkrete të cilat i ka ndërmarrë kjo ministri.

Gjatë raportimit të tij, ministri i Punëve të Brendshme, z. Bajram Rexhepi, tha fillimisht se prioriteti i të gjitha institucioneve është që të kenë rezultate sa më të mira për këtë vit dhe që Raporti i Progresit të jetë sa më pozitiv. Ai theksoi se ministria të cilën e përfaqëson, menjëherë pas publikimit të raportit të KE-së, ka ndërmarrë një sërë veprimesh, duke përfshirë obligimet që janë nxjerrë në bazë të Planit të Veprimit. Ndërkaq, shprehu optimizmin e tij se gjatë këtij viti do të ketë raport më të mirë.

Anëtarët e Komisionit, kërkuar sqarime shtesë nga ministri lidhur me veprimet që ka ndërmarrë kjo ministri për gjendjen në Veri të vendit, si dhe kontrabandën në këtë pjesë. Po ashtu, sqarime kërkuar edhe lidhur me marrëveshjet për ripranim, si dhe për procesin e ri integritetit të personave të riatdhesuar. Më tej, anëtarët e komisionit paraqitën vërejtje për shtyllën operative të Policisë së Kosovës. Madje, disa nga anëtarët e komisionit, shfaqën kritikën e tyre, me theks të veçantë për protokollin e Policisë së Kosovës. Po ashtu, nga ai u kërkuar që MPB-ja të bashkëpunojë me Ministrinë e Bujqësisë lidhur me çështjen për mbrojtjen e pyjeve.

Duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të komisionit, ministri Rexhepi, sa i përket çështjes së veriut tha se

kjo pjesë mbetet sfidë për vendin, duke shtuar se për çdo veprim kërkohet koordinim me faktorin ndërkombëtar, ndërsa, foli edhe për veprimet që po ndërmarrë MPB-ja, lidhur me aktivitetin ilegal të MUP-it në veri.

Ka një numër të madh të policisë që i kryejnë detyrat me përkushtim, megjithatë shtoi ai ka edhe persona që janë të trashëguar nga e kaluara. Z. Rexhepi theksoi se ka pasur disa aksione që janë ndërmarrë në këtë pjesë dhe aksione të tilla do të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Sipas tij në bashkëpunim me EULEX-in gradualisht janë duke bërë evidentimin dhe reformat për respektimin e zinxhirit komandues. "Ky është proces dhe prioriteti i lartë yni, që policia ta kryejë detyrën në mënyrë profesionale dhe të jetë në shërbim të qytetarëve, me qëllim që të implementohet rendi dhe ligji në vend". Z. Rexhepi, shtoi se pretendimet e MPB-së janë që ta pastrojnë policinë dhe vendi të ketë polici profesional. Sa i përket kontrabandës në këtë pjesë, ministri Rexhepi tha se është zvogëluar kontrabanda, meqë janë shtuar kontrollimet nga ana e doganierëve dhe policisë, ndërsa potencoi faktin se çështja e krimit ekonomik do të minimizohet.

Pas raportimit të ministrit Rexhepi në komisionin parlamentar për integritet evropian, anëtarët e komisionit shqyrtuan dhe përkrahën këto projektligje, me amendamentet e komisioneve funksionale, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së: Projektligji nr. 04/L-97 për Bibliotekat në Republikën e Kosovës, Projektligji nr. 04/L-94 për shërbimet e shoqërisë informatike, Projektligji nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat, si dhe Projektligji nr. 04/L-80 për lojërat e fatit.

“Epopeja e UÇK-së”

Epopetë në Prekaz dhe Gllogjan frymëzuan dhe mobilizuan dhjetëra luftëtarë për betejat finale dhe ngadhënjimtare

Sikur dje në luftë edhe sot në paqe, detyrat e mëdha ndaj vendit kryhen më mirë me forca të bashkuara, sepse një është ideali për atdheun



Fjala e kryekuvendarit në manifestimin “Epopeja e UÇK-së në Dukagjin”.

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, mori pjesë në manifestimin “Epopeja e UÇK-së në Dukagjin”. Me këtë rast kryekuvendari Krasniqi iu drejtua të pranishmëve me këto fjalë:”

Të nderuara familje të dëshmorëve
E nderuar familje Haradinaj
I nderuari Rafat Jashari
Të nderuar veteranë të Luftës së UÇK-së
Të nderuar pjesëmarrës
Zonja dhe zotërinj

Na bashkoi sot në këtë vend të trimërive e të traditës së lashtë shqiptare, përvjetori i Epopesë së UÇK-së në Dukagjin dhe nderimi i përvjetshëm dëshmorëve të rënë në altarin e lirisë, na bashkoi 24 marsi, dita e bashkimit të armëve të luftëtarëve tanë të lirisë me NATO-n, aleancën më të madhe ushtarake që ka njohur njerëzimi. Marsi i vitit 1998, me epopetë e tij në Prekaz dhe Gllogjan i dha shpirt dhe forcë Luftës sonë të drejtë çlirimtare, i frymëzoi dhe mobilizoi dhjetëra mijë luftëtarë për betejat finale dhe ngadhënjimtare. Në kujtesën tonë historike, 24 marsi i vitit 1998 shënon një nga ngjarjet kulmore të Luftës së UÇK-së, e cila edhe sot e

gjithmonë do të mbajë të gjallë ndjenjën tonë të krenarisë së ligjshme për lavdinë e luftëtarëve, por edhe dhembjen për sakrificën supreme që ata u desh të bënin për një të drejtë natyrore të njeriut e të kombit.

Një vit më vonë, më 24 mars të vitit 1999, forcat e NATO-s, në krye me SHBA, ndërhyjnë në Kosovë për të ndaluar dhe përzënë përfundimisht makinën vrastare të pushtuesit tonë shekullor. Ky akt solidariteti e human i miqve tanë, do të mbetet në kujtesën e brezave të sotëm dhe të ardhshëm të Kosovës, të cilët do të ruajnë ndjenjën e mirënjohjes së përvjetshme dhe miqësinë e kalitur në orët e vështira të historisë sonë më të re.

Heroizmi i trimave të Gllogjanit e të Dukagjinit ka mbushur faqe lavdie në historinë e Kosovës. Dukagjini i dha ushtarë dhe komandantë të shquar UÇK-së, jo vetëm në këto dhe për këto vise, por për gjithë Kosovën dhe Shqipërinë. Shumë prej tyre ranë në fushën e nderit, si Luani e Shkëlzeni, Edmondi e Salihu, Bekimi e Bedriu, Xhemali e Agimi, e shumë dëshmorë të tjerë që nuk do të vdesin kurrë. Një fjalë thotë, heronjtë, ashtu si veprat e artit, duken më të mëdhenj nga largësia e kohës. Emrat e të rënëve për lirinë e

atdheut, janë skalitur në zemrën dhe kujtesën kolektive të Kosovës, figurat e tyre rriten e madhështohen para brezave nëpër kohët që do të

vijnë në epokën e lirisë. Rruga e jetës së tyre ishte e shkurtër dhe e vështirë, por ajo lavdisë është e përjetshme.



Nderim për Dëshmorët në Glogjan

Mbi këtë Luftë për jetë a vdekje dhe komandantë trima të saj janë vendosur, jo një herë, rreze verifikimi të pastërtisë, por kanë mbetur ashtu siç ishin, diamant të lirisë e të Pavarësisë që e gëzojmë sot. Ne besojmë në drejtësinë ndërkombëtare, ashtu siç besojmë edhe në pastërtinë prej loti të Luftës sonë çlirimtare, prandaj presim që edhe komandanti Ramush Haradinaj dhe bashkëluftëtarët e tij, të shpallën së shpejti të pafajshëm dhe t'i kthehen Kosovës e familjeve të tyre.

Drejtësia ndërkombëtare dy herë në Hagë e në Prishtinë së fundmi, dëshmoi se gjuetia e shtrigave mbi pjesëtarët e UÇK-së ishin dhe janë të padrejta e të motivuara politikisht nga dëshmitarë të yshtur. Ndërsa, ekstradimi i Shemsi Nuhiut nga Zvicra te kriminelët e Beogradit, burgosja e Talakut nga Serbia, me arrestin e shpallur për Fatmir Limën e të tjerët, janë dëshmi që konfirmojnë vazhdimësinë e politikës kriminale të Beogradit ndaj popullit shqiptar. Këto dhe shumë çka tjetër, i flasin politikës sonë se si duhet biseduar me qeveritarët serbë, dhe a duhet biseduar në vazhdimësi me kriminelët e qeveritarëve të Beogradit. Këto veprime të Beogradit zyrtarë, duhet të na bëjnë të nxjerrim mësimin e duhur, kjo do të vlente edhe për miqtë tanë se ne nuk mund të harrojmë gjithçka nga e djeshmja e dhimbshme, ndërsa Beogradi të vazhdojë me krime mbi vendin dhe njerëzit tanë.

Zonja dhe zotërinj

Nuk ka prehje më të qetë për të rënë se kur gjaku i tyre bëhet dritë e themel i lirisë së popullit për të cilin kanë luftuar. Ata ranë duke e lënë Kosovën nën rrënoja, por të sigurt për ngadhënjimin e drejtësisë së luftës së tyre çlirimtare. Ata ranë duke lënë një amanet të madh për bashkëluftëtarët dhe për brezat që do të vinin pas tyre. Kjo porosi, ky ideal i dëshmorëve, vjen sot si një obligim e detyrë e ditës dhe e jetës, për të ruajtur e mbrojtur fitoret e arritura me mund e gjak dhe për ta fuqizuar e përparuar atdheun tonë. Sikur dje në luftë edhe sot në paqe, detyrat e mëdha ndaj vendit kryhen më mirë me forca të bashkuara, sepse një është ideali për atdheun. Të bashkohemi rreth atyre që reflektojnë shpresë e besim, vendosmëri e siguri, guxim e përgjegjësi për të qeverisur me popullin dhe pasurinë e tij, që garantojnë lirinë, pavarësinë, demokracinë dhe zhvillimin e vendit tonë. Gjaku i brezave dëshmorë munda dhe djersa e gjeneratave na obligon dhe nuk na len të qetë përderisa nuk jetësojmë aspiratën shekullore për shtet të lirë, për shtet ligjor e demokratik, shtet ku lulëzojnë vlerat evropiane të popullit tonë. Ky është obligimi ynë që nuk pret.

Lavdi dëshmorëve të lirisë!", theksoi kreu i legjislativit të vendit, Jakup Krasniqi, në manifestimin "Epopeja e UÇK-së në Dukagjin". Kreu i Kuvendit, z. Krasniqi, mori pjesë edhe në ceremoninë e inaugurimit të varrezave të dëshmorëve në Glogjan.

Dëgjim publik i Komisionit për Legjislacion

Diskutim i gjerë për nenin 37 dhe 38 të Projekt-kodit penal të Kosovës, që ka të bëjë me punën e gazetarëve

Komisioni për Legjislacion mbajti dëgjim publik lidhur me Projekt-kodin-penal të Republikës së Kosovës, të kryesuar nga kryetari i komisionit, Arben Gashi. Në takim mori pjesë zëvendëskryeministri dhe Ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, si dhe përfaqësues të Prokurorisë së Shtetit, përfaqësues nga Fakulteti Juridik dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Me këtë rast kryetari i komisionit, Arben Gashi tha se interesim i madh për këtë projekt-kod është shfaqur nga mediat, të cilët kanë shfaqur shqetësimin e tyre për dy nene të këtij projekt-kodi, ku parashihen sanksione penale për përfaqësuesit e mediave, në rastet kur ata përfshihen në vepra të ndryshme penale. Kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me këtë çështje, për heqjen e nenit 37 dhe 38, do të shqyrtohet nga grupi i punës së këtij

komisionit gjatë shqyrtimit të Projekt-kodit penal të Republikës së Kosovës.

“Ne jemi për krijimin e kushteve sa më të mira për mediat dhe të shohim se si përfshihet kjo në bazë të standardeve evropiane, apo se si do të mund të koordinohet më mirë në kuadër të këtij kodi. Qëllimi ynë është që të krijojmë kushte sa më të mira të punës për të gjithë, për prokurorinë, gjykatat, shoqërinë civile, mediat..”, tha Gashi. Ai kritikoi mospjesëmarrjen në këtë dëgjim publik të përfaqësuesve të Shërbimit Korrektues, Shërbimit Sprovues të Kosovës, Këshillit Prokurorial, si dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Të gjitha vërejtjet që dalin gjatë këtij dëgjimi publik do të trajtohen nga komisioni, në mënyrë që të dalim me një produkt sa më të mirë, i cili do të jetë më se i zbatueshëm në vend.



Dëgjim publik i Komisionit për Legjislacion

Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi duke folur në përgjithësi për Projekt-kodin-penal të Republikës së Kosovës theksoi se puna e cila bëhet në komisionin parlamentar për legjislacion është pjesë e orvatjeve tona, në mënyrë që të bëjmë një kod sa më të mirë

dhe sa më të zbatueshëm.

Qëllimi i Ministrisë së Drejtësisë ka qenë që Kodi Penal të jetë modern dhe funksional për vendin, sipas standardeve ndërkombëtare, ndërsa shtoi se deri diku është arritur ky qëllim.

Ministri Kuçi tha se 24 muajt e fundit kanë qenë punë intensive të ministrisë për hartimin e këtij projekt-kodi, duke bashkëpunuar në grupin punues me përfaqësues të MD-së edhe përfaqësues të organizatave joqeveritare, përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe ekspert ligjor nga EULEX-i dhe nga SHBA-të.

Duke përmendur nenet e reja të këtij projekt-kodi siç janë shkalla e dënimit për aktet terroriste, financimit të terrorizmit, mbështetjes për terrorizëm, krimeve ekonomike, korrupsionit dhe keqpërdorimit të pozitës zyrtare, ai tha se kanë përcjellë edhe reagimet të cilat kanë ndodhur gjatë draftimit të këtij projekt-kodi për përgjegjësinë penale të kryeredaktorëve dhe botuesve, që ka të bëjë me nenin 37. Ai sqaroi se neni 37 duhet të hiqet nga Draft-kodi Penal, ku do të garantohet një mundësi

më e madhe për punën e gazetarëve, sepse tashme materia e kontestuar në Draft-kodin Penal rregullohet me Ligjin për përgjegjësin penale të personave juridik. Sa i përket ndëshkimit me burgim të përjetshëm ministri Kuçi tha se kjo është risi për vendin dhe nga burgimi afatgjatë ndryshohet në burgim të përjetshëm. Ndërkaq, ai foli edhe për kapitullin e veçantë që ka të bëjë me veprat penale kundër të drejtës për votim si dhe për veprat penale kundër shërbimeve, me theks të veçantë për vjedhjen dhe mos pagesën e ujit, rrymës dhe shërbimeve tjera. Kuçi theksoi se ky kod penal pretendon të jetë modern dhe t'i përshtatet bazës juridike të Kosovës, ndërsa shtoi se MD-ja është e gatshme të merr pjesë në komisionin parlamentar deri në draftimin final të projekt-kodit.

Rexhep Murati dhe Rexhep Gashi, përfaqësues të Fakultetit Juridik theksuan se janë bërë ndryshime të mëdha në shumë fusha, sidomos në fushën e sistemit të dënimeve, dënimeve alternative, si dhe ka kapituj të posaçëm të veprave penale. Megjithatë, u theksua se ka nevojë që kodi të rishikohet në disa nene dhe të plotësohet.

Besim Kelmendi, prokuror special në Prokurorinë e Shtetit gjatë këtij takimi tha se neni i propozuar në draft kodin që ka të bëjë me lirimin me kusht, është paraparë që komisioni për lirimin me kusht të formohet nga MD-ja, ndërsa sqaroi se propozim i tij është, që ky komision të mos jetë në kompetencë të MD-së, por të jetë kompetencë e Gjykatës Supreme ose Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Kryetari i bordit të Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës (AGPK), Arben Ahmeti, paraqiti shqetësimin e tij pikërisht për nenin 37 dhe 38 të këtij draft-kodi penal të Republikës së Kosovës. Ai theksoi mbrojtjen e burimeve dhe quajti të papranueshme për komunitetin e gazetarëve, duke kërkuar që zbulimi i burimeve të kërkohet vetëm në rastet, kur ka të bëjë me rrezikim të jetës së njeriut.

Anëtari i Komisionit për Legjislacion, Armend Zemaj, tha se ky kod është modern dhe i përgatitur sipas standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, duke theksuar se duhet të bëhet një kod i cili do të jetë në interes të gjithëve qytetarëve.

Edhe Ardian Gjini, projekt-kodin e ri penal e cilësoi si të mirë dhe kjo sipas tij garanton faktin se nuk do të ketë nevojë me vite që të adaptojmë një projekt-kod tjetër.

Anëtarja e këtij komisioni, Albulena Haxhiu, kërkoi sqarime shtesë nga ministri i Drejtësisë, veçanërisht për dënimin me burgim të përjetshëm, kapitullit për të drejtat e votimit, thirrjes për rezistencë, ndërsa tha se çështja e amnistisë duhet patjetër të jetë pjesë në këtë kod.

Dëgjim publik i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore...

Kurteshi: “Ndërhyrja e Qeverisë në pavarësinë buxhetore të këtij institucioni, mos pagesa e zëvendësve të Avokatit të Popullit dhe mungesa e hapësirave teknike, paraqesin sfidë në implementimin e Ligjit”.

Vështirësi të shumta e përcjellin implementimin e Ligjit për Avokatin e Popullit. Kështu u konstatua në dëgjimin publik, organizuar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pa gjetur dhe Peticione i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ky dëgjim publik zhvilloi punimet nën kryesimin e nënkryetares së parë të Komisionit, Rita Hajzeraj - Beqa, e cila fillimisht i njoftoi të pranishmit për qëllimin e këtij debati. Lidhur me këtë, ajo tha se Komisioni në fokus të angazhimeve të tij ka monitorimin e këtij ligji, për këtë ka formuar edhe grupin punues për të parë nga afër ecurinë e zbatimit të Ligjit. Në vijim, Hajzeraj tha se jemi në fillim të monitorimit të këtij Ligji andaj ky dëgjim publik do të mundësojë të kem një pasqyrë reale të implementimit të Ligjit. Ajo kërkoi nga Avokati i Popullit, Ismail Kurteshi që të njoftoi Komisionin lidhur me pyetësonin e formuluar nga Komisioni, e që ka të bëjë me implementimin e Ligjit.

Avokati i Popullit, Ismail Kurteshi, fillimisht njoftoi për sfidat që e përcjellin këtë institucion. Ndërhyrja e Qeverisë në pavarësinë buxhetore të këtij institucioni, mos pagesa e zëvendësve të Avokatit të Popullit dhe mungesa e hapësirave teknike, paraqesin sfidë në implementimin e Ligjit, tha Kurteshi. Ai në vijim foli edhe për disa nene të ligjit të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në punën jo të efektshme të Avokatit të Popullit dhe nëpunësve të institucionit të Avokatit të Popullit. Me këtë rast ai përmendi dispozitën ligjore e cila nuk rregullon si duhet imunitetin e Avokatit të Popullit.



Dëgjim publik i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore...

Duke iu referuar të arriturave të institucionit që ai udhëheq, Kurteshi vuri në pah faktin se ata kanë bashkëpunim të mirë me të gjitha institucionet e vendit. Po ashtu, ai njoftoi se ky institucion ka hapur zyrat e veta në disa komuna, të cilat janë duke funksionuar dhe kontribuar suksesshëm në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Duke iu referuar statistikave, Kurteshi tha se për dallim nga viti i kaluar, në këtë vit ky institucion ka arritur që 60% e rasteve të marrin epilog pozitiv në favor të atyre që kanë kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit.

Lidhur me zbatimin e këtij Ligji, folën edhe përfaqësuesit e Komunës së Prishtinës, Gjilanit dhe Lipjanit. Me këtë rast, ata pasi përshkruan punën dhe koordinimin e aktivitetit të tyre me Zyrën Qendrore të Avokatit të Popullit, bënë vërejtje për shkresat që u dërgohen nga Zyra Qendrore, të cilat ndodh edhe mos t'i marrin. Andaj, ata ishin të mendimit se shkresat që u adresohen zyrave rajonale, duhet ndjekur vijën zyrtare të komunikimit me mundësi të protokollimit të tyre, pranë zyrave të protokollit nëpër komunat përkatëse.

Sadete Demaj përfaqësuese e Zyrës së kryeministrit për qeverisje të mirë. Ajo me këtë rast foli për angazhimin e tyre që këtij institucion t'i krijohen kushte më të mira për punë, ndërkaq, në vijim tregoi për dokumentet e miratuara nga kjo zyrë, e të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen dhe avancimin e të drejtave të njerëzve në nevojë, pavarësisht moshës, gjinisë dhe komunitetit.

Vlladan Trifiq, përfaqësues i një rrjeti të OJQ-ve, vlerësoi se përkthimi i Ligji për Avokatin e Popullit është shumë i dobët në gjuhën serbe. Lidhur me vërejtjet e tij, Kurteshi bëri sqarimet e nevojshme.

Roli i Gruas në Qeverisjen Lokale

Nga mandatet e para të institucioneve me anë të zbatimit të kuotës gjinore u krijuan kushte që kontribuan në përfshirjen e më shumë grave në proceset shoqërore



Pamje nga konferenca

Grupi i Grave Deputete në bashkëpunim me DEMI (Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektiv), që është në kuadër të USAID-it, organizuan një tryezë në Gjilan me temë: Roli i Gruas në Qeverisjen Lokale, në të cilën morën pjesë përfaqësues nga komunat: Gjilan, Shtërpçë, Ranillug, Graçanicë, Partesh, Novobërdë dhe Klllokot. Takimin e hapi drejtorja e DEMI znj. Glinka Kapitanova, e cila foli për rëndësinë e rritjes së efikasitetit të punës në komuna dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së gruas në qeverisjen lokale. “Nga përvoja ime e di se kjo përbën rol sfidues dhe kërkon shumë përgjegjësi, por ne duhet të angazhohemi shumë për rritjen e pjesëmarrjes së gruas në politikë, veçanërisht në vendimmarrje”. Kryetarja e GGD-ës znj. Teuta Sahatqija tha se është mirë që po mbahet kjo tryezë me gratë asambleiste të Komunës së Gjilanit dhe komunave që kryesisht qeverisen nga komunitete jo shqiptare, për ta fuqizuar gruan në të gjitha nivelet anekënd Kosovës. Nga mandatet e para të institucioneve me anë të zbatimit të kuotës gjinore u krijuan kushte që kontribuan në përfshirjen e më shumë grave në procese shoqërore. Kështu tani janë më shumë gra në Parlament dhe institucione qendrore dhe lokale, por duhet bërë më shumë që gratë nga komunat të të gjitha komuniteteve të fuqizojnë gruan në nëndegët, degët dhe nivelin qendror të partive,

sepse vetëm duke forcuar gruan në partitë politike ato do të mundë të zgjedhën kryetare komunash, kryesuese kuvendesh komunale, udhëheqëse qeverish lokale, drejtore etj. Deputetja znj. Flora Brovina po ashtu foli për punën e madhe që duhet bërë në nivelin lokal, sidomos në fuqizimin ekonomik të gruas. Në këtë drejtim ajo theksoi rëndësinë e zhvillimit të veprimtarisë zëjtare e cila është mundësi e mirë për punësim të grave. Panelistja Vesna Mikiq nga komuna e Ranillugut foli për pozitën e grave serbe, pozitë e cila nuk është e mirë në radhë të parë për shkak se ato kryesisht jetojnë në komuna jo aq të zhvilluara. Deputetja nga Gjilani znj. Lirie Kajtazi kërkoi nga gratë e asambleve që të jenë aktive në politikat e komunës, sidomos për të adresuar çështjet që lidhen me jetën e qytetarit, të gruas dhe fëmijëve. Në diskutim morën pjesë edhe asambleistët nga komunat. Në fund të debatit u dhanë këto rekomandime:

- Të respektohen ligjet në fuqi mbi çështjet që lidhen me gruan;
- Të rritet angazhimi i grave në proceset e politikëbërjes në komuna
- Të vazhdohet me zbatimin e kuotës gjinore në zgjedhje;
- Të rritet niveli i vetëdijesimit të gratë dhe burrat mbi nevojën e përfshirjes së grave në vendimmarrje.

Vizitë e Komisionit për Punë të Brendshme në Gjermani

Vizita është organizuar nga Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim e Gjermanisë dhe është pjesë e projektit “Kontrolli Demokratik i Sektorit të Sigurisë”



Në kuadër të bashkëpunimit me komisionet homologe të parlamenteve të tjera, Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i drejtuar nga Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit, është duke zhvilluar një vizite studimore në Republikën Federale të Gjermanisë nga data 25 deri më 31 mars 2012. Kjo vizite është organizuar nga Ministria Federale për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim të Gjermanisë dhe është pjesë e projektit “Kontrolli Demokratik i Sektorit të Sigurisë”. Gjate këtyre ditëve komisioni ka pasur shumë aktivitet ku mes tjerash është pritur nga kryetarja e Komisionit të Mbrojtjes së Bundestagut zj. Susanne

Kastner dhe anëtar të tjerë të komisionit me të cilët është diskutuar për situatën në Kosovë e veçanërisht në veri të vendit, për angazhimin e trupave gjermane të KFOR-it dhe kontributin që shteti gjerman ka dhënë për Kosovën. Delegacioni nga Kosova ka vizituar edhe Qendrën e trajnimeve për misione jashtë vendit të Bundesverit dhe Shtabin e Përgjithshëm të Bundesverit ku është njohur me funksionimin e komandës për misione jashtë vendit të ushtrisë gjermane. Komisioni do të ketë takime të tjera të rëndësishme në Ministrinë Federale të Mbrojtjes, me Komisionarin për Ushtrinë, Ministrinë për Zhvillim Ekonomik dhe Akademinë Federale për Politikë të Sigurisë.

Pyetje pa përgjigje

Deputetja Blerta Deliu PDK

1- Për ministrin e Shëndetësisë, z. Ferid Agani

Z. ministër, sindikatat e mjekëve po paralajmërojnë krizë kuadrosh në Kosovë, veç disa fushave që tashmë janë deficitare, nëse do të vazhdojë ky trend i ikjes së tyre nga vendi. Sa është shqetësuese kjo dukuri për shëndetësinë kosovare?

Deputetja Albulena Haxhiu VV

1- Për kryeministrin z. Thaçi

Pse me gjithë deklaratimet tuaja, ju lejoni aktivitet të strukturave ilegale në organizimin e zgjedhjeve dhe jo vetëm këtë aktivitet dhe me çfarë baza ligjore dhe kushtetuese jeni mbështetur kur keni deklaruar se do të lehtësoni pjesëmarrjen në votim, në organizimin e zgjedhjeve të shtetit serb?

Deputetja Alma Lama VV

1- Për kryeministrin z. Thaçi

Përse qeveria nuk e ka sjellë në kuvend projektligjin për legalizimin e ndërtimeve pa leje, i cili është përgatitur që prej vitit 2009 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor?

Deputeti Lutfi Haziri LDK

1- Për ministrin e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, z Gashi

Përmbytjet në Komunën e Vitisë dhe vetë qytetin ka dëshmuar sa e dëmton qytetarin dhe pronën e tij çdo vit dalja nga shtrati e lumit Morava. Kur planifikoni të filloni këtë projekt dhe sa është kostoja ? A do të kompensoni demet e shkaktuara në pronat private dhe tokat bujqësore

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, AAK

1- Për Ministren e Tregëtisë dhe Industrisë znj. Mimoza Kusari – Lila

Në këtë Kuvend por edhe në media në vazhdimësi deklaroni se Kosova po i zbaton masat e reciprocitetit me Serbinë, ndërsa e vërteta është ndryshe. Si e kuptoni ju reciprocitetin?

2- Për kryeministrin z. Thaçi


Arespektohet marrëveshja për partneritetin Publiko – Privat në aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës si dhe kush e bën mbikëqyrjen e implementimit të projektit sipas kritereve të nënshkruara në kontratë?

Deputeti Agim Kuleta, Lëvizja për Bashkim

1- Për kryeministrin z. Thaçi

Pse qeveria e Kosovës deri më sot nuk ka ndërmarrë asnjë hap konkret për kthimin e këtyre njerëzve në pronat e veta dhe cili është qëndrimi juaj për të ardhmen e kësaj çështjeje? Pra , a do të merreni në të ardhmen me këtë problem apo e konsideroni çështje të mbyllur, pra realitet të pakthyeshem.

Nishani: Shqipëria ndjek me interes të veçantë të gjitha zhvillimet në Kosovë



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti në takim ministrin e Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani, me të cilin bisedoi për bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në të gjitha fushat, me theks të veçantë, në atë të sigurisë.

Ministri Nishani tha se qeveria shqiptare ndjek me interes dhe ndjeshmëri të veçantë të gjitha zhvillimet në Kosovë. Z. Nishani e falënderoi në mënyrë të veçantë kryetarin Krasniqi dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës për mbështetjen që i kanë dhënë rritjes së bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, në të gjithë fushat. Ai veçoi një varg masash që janë ndërmarrë për lehtësimin e kalimit kufitar ndërmjet dy vendeve, si dhe eliminimit të pengesave të qarkullimit rrugor në Shqipëri, për qytetarët e Kosovës.

Kalimi kufitar nëpërmjet vetëm një kontrolli, gjatë verës, ka krijuar lehtësi të madhe për qytetarët dhe ka mundësuar identifikimin e një sërë të kërkuarve nga të dy vendet, për vepra të ndryshme penale.

Kryetari i Kuvendit e vlerësoi si shumë të mirë bashkëpunimin ndërmjet dy parlamenteve, me ç'rast përmendi vizitat e ndërsjella, pjesëmarrjen nëpër aktivitete të parlamenteve respektive, njohjen me praktikat parlamentare në të gjitha fushat etj.

Kryetari Krasniqi, duke shfaqur kënaqësinë për rritjen e komunikimit e të bashkëpunimit ndërmjet sektorëve të veçantë të të dyja shteteve, përfshirë edhe atë të sigurisë, garanto mbështetjen e plotë të Kuvendit në hapat e mëtejshme dhe ndërmarrjen e veprimeve legislative, konform nevojave që dalin para tij.

Arifi; Marrëveshja e Ohrit - është shtyllë e stabilitetit të Maqedonisë

Zëvendëskryeministrja për Çështje Evropiane të Republikës së Maqedonisë, znj. Teuta Arifi, pasi u falënderua për pritjen, i bëri një vështrim përpjekjeve që po bën Maqedonia drejt integriteteve evropiane. Në këtë kontekst, ajo foli edhe për bashkëpunimin me Kosovën dhe shtetet tjera të Rajonit. Marrëveshja e Ohrit, tha ajo, është shtyllë kryesore e stabilitetit të Maqedonisë. Ajo u ndal edhe në incidentet e fundit në Maqedoni, të cilat tregojnë ndjeshmërinë e tyre, ndaj edhe trajtohen me seriozitet, duke mos lënë hapësirë për qasje selektive. Zonja Arifi vlerësoi pozitivisht vlerësimet e qeverive përkatëse të Kosovës dhe të Shqipërisë për këtë çështje, të cilat ishin konstruktive e në frymë të proceseve euroatlantike.

Kryetari i Kuvendit Krasniqi vlerësoi arritjet e Maqedonisë në rrugën drejt integriteteve evropiane. Duke folur për marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë, kreu i legjislativit të vendit theksoi: "Duhet të përqendrohemi në krijimin e marrëdhënieve sa më të mira, marrëdhënie partneriteti, të cilat duhet të përforcohen gjithnjë".

Bashkëbiseduesit ishin unik në konstatimin se institucionet e të dy shteteve duhet të shpresojnë kontaktet për të thelluar edhe më bashkëpunimin në të gjitha fushat.



Kryetari i Kuvendit priti një delegacion të Kuvendit Kombëtar Hungarez

Një delegacion parlamentar nga Hungaria, anëtarë të Komisioneve të Mbrojtjes dhe Sigurisë të Kuvendit Kombëtar Hungarez, të kryesuar nga Csampa Zsolt, nënkryetar i Komisionit të Mbrojtjes, pritën në një takim nga kryetari i Kuvendit të Kosovës z. Jakup Krasniqi.

Kryetari Krasniqi, duke shfaqur kënaqësinë për rritjen e komunikimit e të bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve, përkatësisht, dy parlamenteve, shprehu interesimin dhe gatishmërinë që ky bashkëpunim të thellohet e zgjerohet edhe më tej. Z. Krasniqi vlerësoi bashkëpunimin ndërmjet administratave të të dy parlamenteve, duke përmendur Projektin e Binjakëzimit “Mbështetje për Kuvendin e Kosovës”, projekti ky i financuar nga Komisioni Evropian por që do të implementohet nga Kuvendi Kombëtar Hungarez.

Nënkryetari i Komisionit të Mbrojtjes të Kuvendit Kombëtar të Hungarisë, Csampa Zsolt, nga ana e tij, duke përcjellë përshëndetjet e kryeparlamentarit hungarez, bashkëpunimin ndërmjet dy parlamenteve e cilësoi të një rëndësie të veçantë, posaçërisht atë ndërmjet komisioneve homologe dhe shfaqti gatishmërinë për të ofruar përvojën parlamentare hungareze.



Anne Meskanen - Kosova për Finlandën përbën prioritet në rajon

Zhvillimet aktuale në vend dhe thellimi i bashkëpunimit të mëtejshëm ndërmjet Kosovës dhe Finlandës, posaçërisht ndërmjet dy parlamenteve përkatëse, ishte temë thelbësore e takimit të sotëm të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, me të ngarkuarën me punë në Ambasadën e Finlandës në Prishtinë, znj. Anne Meskanen.

Kryekuvendari Krasniqi duke i uruar mirëseardhje znj. Meskanen, e vlerësoi shumë të rëndësishme vizitën që kishte bërë në Finlandë dhe takimet frytdhënëse që ka pasur me drejtuesit e lartë të institucioneve të këtij vendi mik. “Finlanda ka përkrahur dhe përkrah shumë Kosovën viteve të fundit, duke mos harruar edhe kontributin e presidentit Ahtisaari, si dhe praninë e trupave finlandeze në kuadër të KFOR-it që veprojnë në Kosovë”.

Znj. Anne Meskanen tha se Kosova për Finlandën përbën prioritet në Rajon. Ajo në vijim u interesua për procesin e ndryshimeve kushtetuese që kanë të bëjnë me zgjedhjen e presidentit të vendit, miratimin e ligjeve nga Pakoja e Ahtisaarit nga ana e Kuvendit të Kosovës, duke shfaqur interesim njëkohësisht edhe për procesin e heqjes së mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.





KULLË TRADICIONALE, PEJË



PRIZREN



Vizitë e ish- shefit të Zyrës Amerikane në Prishtinë,
Ambasadorin Menzies, i shoqëruar edhe nga 20 studentë të "Setten Hall University".